



**DISA ÇËSHTJE TË NDËRTIMIT DHE ZBATIMIT TË  
POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË**

**Propozim për diskutim  
14 Shkurt 2001**

**Nga projekti „ Promovimi i Zhvillimit Ekonomik përmes Shoqërisë Civile“  
mbështetur nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim  
Ndërkombëtar  
(USAID)**

**Instituti për hulumtime zhvillimore RIINVEST - Prishtinë/ Qendra për  
Ndërmarrjet Ndërkombëtare Private - Ëashingtoni (CIPE)**

Bulevardi i Dëshmorëve Nr. 4/III Prishtinë  
Tel/Fax:++381 38 549-320  
E-mail: riinvestcom@hotmail.com

## **PËRMBAJTJA**

- I. HYRJE
- II. QËLLIMET
- III. METODOLOGJIA
- IV. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE
- V. SFIDAT E POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË DHE AUTORITETI QENDROR FISKAL
- VI. STRUKTURA EKZISTUESE E OBLIGIMEVE FISKALE NË KOSOVË
- VII. NORMA TË DIFERENCUARA APO LINEARE FISKALE
- VIII. TATIMET E REJA ME THEKS TË VEÇANTË NË TATIMIN NË VLERËN E SHTUAR
- IX. DECENTRALIZIMI I POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË
- X. PËRFUNDIMET

### **Anekset:**

Aneksi 1.	Përvojat fiskale në Kosovë para lufte
Aneksi 2 tranzicion	Vështrim mbi Politikën Fiskale në disa shtete në
Aneksi 3	Të dhëna statistikore
Aneksi 4	Të dhënat preliminare nga anketa e Riinvestit me ndërmarrjet private (Dhjetor 2000)
Aneksi 5	Rregulloret mbi politikën fiskale
Aneksi 6	Referencat

## **DISA ÇËSHËTJE TË NDËRTIMIT DHE ZBATIMIT TË POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË**

### **I. HYRJE**

Instituti “Riinvest” në bashkëpunim me CIPE në Vashington dhe në mbështetje të USAID është duke e realizuar Projektin “Promovimi i zhvillimit ekonomik përmes shoqërisë civile”. Projekti ka për qëllim që të përmirësojë politikën ekonomike dhe rrethinën e biznesit në Kosovë, (i) përmes rritjes së pjesëmarrjes së faktorit lokal në hartimin e politikave ekonomike dhe (ii) inkuadrimit të politikës kosovare dhe të komunitetit të biznesit në proceset zhvillimore. Projekti do të hulumtojë një varg çështjesh të politikës fiskale dhe do të prezantojë rekomandimet sipas fushave dhe bartësve të tyre, të cilat do të shqyrtohen në Tryezën e Forumit Ndërkombëtar.

Raporti i parë të cilin Riinvesti do ta përgatisë dhe do ta prezantojë është politika fiskale. Të vetëdijshëm se politika tatimore është një nga elementet e një lëmie më të gjërë që njihet si politikë fiskale, do të përqipemi që në këtë punim të veçojmë disa çështje të cilat mendojmë se janë më të rëndësishme. Megjithatë një nga konstatimet tona për politikën aktuale tatimore në Kosovë është mungesa e një strategjie dhe vizioni të mirfilltë për të balancuar në mënyrë më të kurtë ngarkesat fiskale në mes të komunitetit të biznesit dhe të popullatës. Prandaj ky raport do të bëjë përpjekje që përmes sigurimit të materialit dokumentues dhe informativ që i referohet politikës fiskale të ndihmojë në pasqyrimin dhe vlerësimin sa më të plotë të gjendjes së tatumëve dhe detyrimeve të tjera fiskale.

### **II. QËLLIMET**

Si qëllim përfundimtar i këtij hulumtimi do të jetë të rekomandojë dhe të advokojë një politikë të qëndrueshme fiskale që do të zhvillohej me kombinimin e ndryshimeve të sistemit ekzistues dhe inkuadrimit të komponenteve të reja si janë:

- Harmonizimi i ngarkesës fiskale në mes komunitetit të biznesit dhe popullatës;
- Mbështetja më e madhe e saj në nevojat e zhvillimit ekonomik të Kosovës;
- Të jetë në funksion të rindërtimit ekonomik të Kosovës pas luftës.

Ky raport i ka adresuar disa çështje dhe probleme që përfshijnë:

- Strukturën administrative të financave publike të Kosovës;
- Strukturën e ngarkesës fiskale;
- Qëndrimet e komunitetit të biznesit lidhur me strukturën aktuale të ngarkesave fiskale, dhe
- Rekomandimet për përmirësimin e politikës tatimore.

Me këtë hulumtim përfshihen:

- Analiza e strukturës ekzistuese të tatimeve në Kosovë dhe ndikimin e kësaj strukture në zhvillimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla (NMV-ve);
- Shqyrtimin e tatimeve të reja që priten të aplikohen;
- Një vështrim mbi politikën fiskale në vendet në tranzicion, në vendet fqinje dhe të ato me ekonomi të zhvilluar;
- Rekomandimet për një kombinim optimal të tatimeve nëpërmjet të cilit do të zgjerohet baza fiskale dhe do të arrihet një rishpërndarje më e mirë e ngarkesës fiskale midis bizneseve dhe popullatës.

Besojmë se implementimi i rekomandimeve do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e biznesit në Kosovë, përmes:

- Hapjes së mundësive të reja të punësimit;
- Kurajimit të investimeve më të mëdha;
- Rritjes së diciplinës fiskale;
- Reduktimit të evazionit fiskal.

### III. METODOLOGJIA

Në përgaditjen e këtij studimi përveq aktiviteteve hulumtuese të stafit të Riinvestit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm janë shfrytëzuar edhe rezultatet e projekteve të realizuara deri tash të këtij Instituti si:

- “Aktivitetet Ekonomike dhe Zhvillimi Demokratik i Kosovës”;
- “Ndërtimi dhe funksionimi i institucioneve të pushtetit lokal në Kosovë”;
- “Rindërtimi i Kosovës pas luftës”;
- Anketës në 300 ndërmarrje private 1997, 1999 dhe 2000;
- Anketës në 194 ndërmarrje shoqërore në vitin 2000 dhe
- Anketës në 3500 familje dhe ekonomi familjare.

Në kuadër të aktivitetit për përgaditjen e këtij studimi, në bashkëpunim me CIPE, kemi organizuar edhe një Tryesë e ekspertëve në të cilin kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar aktivisht përfaqësuesit e Autoritetit Qendror Fiskal, USAID-it, Departamentit për Tregti dhe Industri, Odës Ekonomike të Kosovës si dhe përfaqësues nga Fakulteti Ekonomik i Prishtinës dhe ekspertë të pavarur nga lëmia e politikës fiskale.

Me qëllim të përkufizimit të kornizave të studimit dhe të harminizimit të aktiviteteve janë mbajtur dy takime në Autoritetin Qendror Fiskal, pastaj disa takime në USAID dhe në Riinvest me përfaqësuesit e këtij asociacioni si dhe janë mbajtur kontakte të rregullta me përfaqësuesit e CIPE.

Lidhur me shfrytëzimin e përvojave të vendeve në tranzicion Riinvesti ka realizuar një udhëtim studiues në Poloni përmes të cilit janë studiuar përvojat e këtij vendi në sferën e politikës fiskale me theks të posaçëm në taksat lokale dhe strukturën e të hyrave dhe shpenzimeve të pushtetit lokal. Gjithashtu, në këtë studim, duke shfrytëzuar literaturën e Institutit, Internetin dhe kontaktet me eksperte të pavarur,

kemi bërë prezentimin e përvojave të vendeve në tranzicion, të vendeve të rajonit dhe të Evropës Qëndrore, por edhe krahasimi i tyre me vendet e zhvilluara perendimore në kuadër të Unionit European, OECD dhe të grupacioneve tjera.

#### **IV. PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE**

Tabela në vijim sintetizon një listë të rekomandimeve që dalin nga ky material, të cilat besojmë se do të shërbejnë si bazë për diskutimin dhe do ta ndihmojnë aktivitetin vijues për advokimin lidhur me involvimin e komunitetit të biznesit, administratës publike, shoqërisë civile, mediave dhe grupeve të tjera në ndërtimin e mëtutjeshëm të politikës fiskale në Kosovë.

Çështjet kryesore të cilat meritojnë vëmendjen tonë në kuadër të këtyre rekomandimeve janë si vijon:

- Ndërtimi i kriterëve gjithëpërfshirëse dhe parimeve të qëndrueshme mbi të cilat do të bazohet politika e re fiskale në Kosovë:
- Zgjerimi i bazës tatimore krahas rishqyrtimit të ngarkesave tatimore me qëllim që këto ngarkesa të jenë në harmoni me aftësitë e taksapaguesve për përmbushjen e obligimeve të tyre fiskale.
- Politika fiskale të nxisë investimet dhe zhvillimin ekonomik.
- Aplikimi i instrumenteve të reja fiskale.
- Decentralizimi fiskal.
- Zvoglimi i evazionit fiskal.
- Rritja e kapaciteteve operative dhe menaxherike fiskale në kuadër të administratës tatimore, shtimi i diciplinës dhe transparencës fiskale.

**REKOMANDIME****DISA ÇËSHTJE TË NDËRTIMIT DHE ZBATIMIT TË POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË**

LËMIA	PËRMBAJTJA	Qëllimet		Adresuar
		strategjike	operative	
<b>Formulimi dhe implementimi i politikës fiskale</b>	Ndërtimi i kriterëve dhe principeve të qëndrueshme	Kompatibiliteti me ekonominë e hapur të tregut.	Hartimi i një programi dhe strategjie mbi ndikimin e politikës së qëndrueshme fiskale në pajtim me kërkesat e stabilitetit makroekonomik dhe zhvillimit afatgjatë.	AQF/ Parlamenti, Qeveria, Ministria e Financave, Pushteti lokal
		Sigurimi i barazisë në treg dhe konkurrencës korrekte	Zhvillimi i kombinimeve fleksibile të tipeve të ndryshme të doganave, tatimeve dhe taksave	AQF, Oda ekonomike/Parlamenti, Qeveria,
		Transparenca e vazhdueshme në relacionin e taksapaguesve dhe të administratës tatimore.	Thellimi i besimit në autoritetet fiskale	AQF, Pushteti lokal
		Stimulimi i investimeve të reja, punësimit të ri, tërheqja e kapitalit të jashtëm.	Definimi i rolit stimulantiv të tatimeve.	Unmik, KPA, AQF, Bankat/Parlamenti, Qeveria, Pushteti lokal
		Respektimi i nevojave reale buxhetore.	Hartimi i analizës mbi efektet e politikës fiskale në zhvillim dhe problemet sociale (sigurimi i nivelit të mjaftueshëm të pagave, pensione dhe ndihmave sociale për popullatën e rrezikuar; sigurimet në rast papunësie.	AQF/Qeveria

<b>Baza fiskale</b>	Zgjerimi i bazës fiskale dhe harmonizimi i ngarkesës fiskale me mundësitë e taksapaguesve	<p>Ngarkesat fiskale të jenë të përballueshme për taksapaguesit</p> <p>Të ndihen efektet e taksave dhe tatimeve në funksionimin e shërbimeve publike në dobi të taksapaguesve.</p> <p>Tejkalimi i koncentrimit të ngarkesave fiskale ndaj komunitetit të biznesit.</p> <p>Lehtësitë tatimore në funksion zhvillimor</p> <p>Sendërtimi barazisë fiskale dhe krijimi i opinionit pozitiv tek taksapaguesit</p>	<p>Rishqyrtimi i lartësisë së taksave me mundësi të zvogëlimit të tyre. Harmonizimi i ngarkesave fiskale me të ardhurat, pasurinë dhe aftësinë paguese të taksapaguesve.</p> <p>Pasqyrimi i masave për zhvillimin e lëmive publike, infrastrukturës, forcimit të rendit dhe ligjshmërisë.</p> <p>Zgjerimi i bazës fiskale mbi të gjitha burimet e fitimit të individëve dhe kompanive.</p> <p>Aplikimi i lehtësirave për importin e makinerisë së shkatruar apo plaçkitur, importin e lëndës së parë për prodhimtarinë për eksport dhe investime.</p> <p>Zbatimi rigoroz i ligjshmërisë dhe disiplinës në organet doganore dhe tatimore; mbulimi i të gjitha pikave kufitare të Kosovës si pika doganore.</p>	<p>AQF/ Qeveria</p> <p>UNMIK, AQF</p> <p>UNMIK, Pushteti lokal</p> <p>AQF, Oda ekonomike/ Qeveria dhe Ministria e Financave</p> <p>UNMIK, AQF, KFOR/ Parlamenti dhe Qeveria</p>
<b>Rritja e kapacitetit fiskal dhe decentralizimi fiskal</b>	<p>Investimet në forcimin e bazës ekonomike.</p> <p>Instrumentet e reja fiskale</p>	<p>Hecja drejt nje buxheti vetefinancues perms mbeshtetjes se bizneseve dhe investimeve të jashtme.</p> <p>Përshtatja e instrumenteve fiskale sistemit fiskal të vendeve në tranzicion, të vendeve fqinje dhe atyre të zhvilluara.</p>	<p>Sigurimi i burimeve të volitshme financiare, garantimi i investimeve të jashtme.</p> <p>Përgatitjet dhe sigurimi i klimës për aplikimin e suksesshëm të Tatimit në vlerën e shtuar, të tatimit në fitim dhe tatimit në paga.</p> <p>Ndërtimi i infrastrukturës ligjore dhe</p>	<p>Banka botërore, Autoriteti bankar , AQF, /Qeveria,</p> <p>KPA, AQF, P. Politike, Shoqatat afariste, mediat, OJQ,</p>

	Decedntralizimi fiskal	<p>Përcaktimi i drejtë i ndarjes së të hyrave publike në mes pushtetit qendror dhe komunave; krijimi i kushteve për autonomi të pushtetit lokal.</p> <p>Identifikimi i burimeve të reja të financimit.</p>	<p>edukimi i tatimpaguesve. Përgatitja për aplikimin e tatimit në të ardhura të përgjithshme të qytetarëve.</p> <p>Definimi i sistemit të ndarjes së të hyrave burimore në mes pushtetit lokal dhe qendror; definimi i sistemit të ndarjes së shpenzimeve në mes pushtetit qendror dhe lokal; definimi i shkallës së decentralizimit të vendosjes në përcaktimin e të hyrave dhe shpenzimeve.</p> <p>Përcaktimi i tatimit në pasuri të patundshme, tatimit në qarkullimin e pasurisë së patundshme dhe mbi fitimin nga kapitali, tatimit mbi qiratë, tatimit në të hyra katastrale, taksat në reklama, taksat për ndërtime të reja, taksat për peshkim, për gjueti dhe taksat për shërbimet e organeve të administratës komunale.</p>	<p>UNMIK, OESC, AQF/ Parlamenti, Qeveria.</p> <p>AQF, Pushteti local/ Parlamenti, Qeveria, ministritë përkatëse, Oda ekonomike, Institucionet e pavarura shkencore.</p>
<b>Evazioni fiskal</b>	Ndërtim i masave dhe instrumenteve për luftimin e evazionit fiskal.	Eliminimi i ekonomisë joformale dhe futja e saj në rrjedha legale.	<p>Aprovimi dhe zbatimi i ligjeve nga fusha ekonomike.</p> <p>Aftësimi i operativës kontroll dhe zbatimi i dënimeve rigorozë për hikje nga obligimet tatimore;</p> <p>Sigurimi i barazisë së plotë të detyruesve doganor dhe tatimor;</p> <p>Sigurimi i infrastrukturës juridike për udhëheqjen e evidencës kontable në bazë të standardeve ndërkombëtare.</p> <p>Doganimi dhe tatimimi i plotë i vlerës së mallrave që importohen;</p>	UNMIK, Shtylla 4, KFOR Banka botërore, Oda ekonomike/ Parlamenti, orgnet e rendit publik



<b>Kapacitetet operative dhe mengjerike fiskale</b>	Zhvillimi mëtejshëm i kapaciteteve operative dhe menagjerike.	Përcaktimi i statusit doganor përgjat tër kufirit të Kosovës.	Pavarësimi i organeve doganore dhe tatimore nga influencimet e ndryshme dhe mbrojtja dhe sigurimi i tyre.	
		Aktivizimi i instrumenteve fiskale lokale.	Mbulimi i kufijve të Kosovës me pika të kontrollit doganor dhe tatimor. Rishqyrtimi i statusit preferencial ndaj IRJM.	AQF, Pushteti local.
		Advokatimi dhe krijimi i klimës së favorshme në opinion për një sistem të pranueshëm dhe efektiv fiskal dhe në funksion të zhvillimit të biznesit.	Përgatitja e administratës lokale tatimore.	AQF, Partitë politike, mediat, OJQ, institucionet shkencore.
		Përparimi i organizimit të AQF-së si dhe administratës tatimore në pushtetin lokal.	Hartimi dhe aprovimi i një programi të zhvillimit të kulturës fiskale mbi transparencën dhe komunikimin me taksapaguesit.	AQF, Pushteti local, Institucionet shkencore.
		Transparenca e vazhdueshme fiskale	Kyqja më e madhe e stafit lokal në përgatitjen e konceptit të politikës fiskale dhe realizimin e saj; Përgatitja e ekipeve për përcjelljen dhe interpretimin e indikatorëve makroekonomik dhe të ecurive mikroekonomike, Përgatitja dhe edukimi i stafit punues. Trajnimi dhe përgatitja e stafit në pushtetin lokal	AQF, Pushteti lokal, mediat.

## V. SFIDAT E POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË DHE AUTORITETI QENDROR FISKAL

Politika fiskale njihet si proces i formulimit të tatimimeve dhe të shpenzimeve publike në funksion të gjenerimit të cikluseve rritëse ekonomike dhe të disperzionit ekonomik të cilësuar me shkallë të lartë punësimi dhe të mbrojtur nga ciklet inflatore. Politika fiskale përmes mekanizmave të saj është në funksion të mobilizimit të resurseve financiare për alimentimin e nevojave publike, duke agreguar njëkohësisht funksionet kyçe ekonomike dhe sociale në fushën e alokimit të resurseve ekonomike, redistribuimit të të ardhurave kombëtare, stabilitetit të çmimeve, rritjes së punësimi dhe efikasitetit ekonomik. Në përgjithësi qëllimet e politikës fiskale gjat ndërtimit gradual të saj tek ne do të përqëndroheshin në përcaktimin e nivelit të doganave dhe taksave, respektivisht të shpenzimeve publike, për të siguruar ngritje të shpejtë ekonomike me punësim të lartë dhe çmime stabile.

Definimi dhe formulimi i një politike konzistente afatgjate fiskale në Kosovë është i përkufizuar me shumë pengesa, nga të cilat më karakteristike janë:

- Statusi specifik politik i Kosovës në këtë fazë;
  - Gjendja e rëndë ekonomike e pasluftës;
  - Mungesa e sistemit statistikor, institucioneve statistikore dhe e indikatorëve makroekonomik për formulimin e politikës fiskale;
  - Moskonsolidimi i administratës lokale tatimore.
- a) Krijimi dhe ndërtimi i politikës fiskale në Kosovë po bëhet në kushte mjaft specifike. Akoma nuk është hartuar dhe miratuar një koncept i tërësishëm ekonomik, përkundër asaj që ekziston një orientim i përgjithshëm për ekonomi të hapur të tregut. Përkufizimi i sistemit ekonomik domosdo është i ndërlidhur me statusin e Kosovës, i cili përkohësisht përcaktohet me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kosova nuk e ka valutën e vet, prandaj edhe nuk ka funksion të politikës monetare, e cila do të korespondonte ngushtë me politikën fiskale gjatë definimit dhe ndërtimit të saj. Rrethanat specifike në të cilat ndodhet Kosova cilësohen momentalisht me:
- Strukturën administrative shumkombëshe.
  - Angazhimin e donatorëve të jashtëm për financimin e një pjese të konsiderueshme të nevojave buxhetore
  - Ndarjen e buxhetit në pjesën e cila financohet pjesërisht nga taksat e brendshme dhe pjesërisht nga donatorët dhe në pjesën e cila krejtësisht mbështetet në donatorët.
  - Transakcionet ekonomike me para në dorë, të bazuara kryesisht mbi Markun Gjerman.
  - Mosfunksionimin (ose funksionimin e pjesshëm) të sistemit bankar.
  - Mungesën e evidencës kontable në afarizmin ekonomik-financiar të ndërmarrjeve.
  - Mungesën e instrumenteve të brendshme financiare.
  - Mosfunksionimi i doganave në tërësinë kufitare të Kosovës.

- b) Ekonomia e Kosovës është e shkatërruar nga efektet e luftës, plaçkitjes dhe shfrytëzimit pa mirëmbajtje dhe investime vijuese të pajimeve për një periudhë të gjatë. Sipas vlerësimeve të Institutit Riinvest dëmet dhe pasojet nga lufta në ndërmarrjet shoqërore janë rreth 1.3 miliard DM. Janë shkatërruar pronat, pasuritë dhe mekanizmi bujqësor. Vlerësohet se 92% e ndërmarrjeve private pësuan dëme të konsiderueshme nga lufta. Fondi i banimit të shtëpive private pas lufte ishte zvogëluar për rreth 40%, të ardhurat në buxhetet familjare për 70%, ndërsa pajisjet shtëpiake 70-80%. Infrastruktura e shkatërruar rrugore dhe komunale si dhe niveli i ultë i shërbimeve komunale kërkojnë fonde të mëdha investuese për aftësimin e tyre. Vlerësohet se dëmet në ndërmarrjet publike komunale arrijnë rreth 130 milion DM. Gjendja sociale është në nivel shumë të ulët. Shumica e popullatës është e pa punë, kurse ata që marrin paga nuk arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet minimale jetësore. I madh është problemi i punëtorëve të cilët më parë janë nxjerrur me dhunë nga puna dhe jetojnë pa pensione dhe pa asistencë. Numri i pensionistëve të cilët nuk kanë marrë pensione për afër 3 vjet sillet rreth 90.000 vetë. Nuk janë siguruar pensionet as për punëtorët që po pensionohen tani. Kjo e ashpëron problemin e politikës financiare, veçmas të buxhetit.
- c) Në Kosovë akoma nuk është rregulluar përcjellja e indikatorëve ekonomik, nuk janë organizuar institucionet përkatëse dhe nuk është përcaktuar metodologjia e përpunimit dhe pasqyrimin të indikatorëve bazë. Në përcaktimin e politikave ekonomike rëndom shfrytëzohen të dhëna jo të plota, të siguruar nga burime segmentare. Kështu që ndihet mungesa e indikatorëve të domosdoshëm lidhur me përmasat e rritjes së ekonomisë, vlerësimin e brutoproductit vendas (GDP), të ardhurave kombëtare, përpjestimive të përfshirjes së të hyrave publike në GDP etj. Është shumë i qëlluar organizimi i njësisë për analiza makroekonomike pran AQF-së.

Në kuadër të rregulloreve të UNMIK-ut në Kosovë si infrastrukturë elementare juridike janë nxjerrë: Rregullorja mbi importimin dhe shitjen e derivateve të naftës, Rregullorja mbi rregullimin e shërbimit të postës dhe telekomunikacionit në Kosovë, Rregullorja mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal, Rregullorja mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave, Rregullore për liçencimin, mbikqyrjen dhe rregullimin e bankave ( lista complete ipet në aneksin 5). Megjithatë akoma as për afërsisht nuk është rumbullaksuar rregullativa ligjore nga kjo lëmi. Me qëllim të komplementimit të rrethinës institucionale, veçmas duhet të nxjerren edhe këto ligje:

- *Ligji komercial;*
- *Ligji mbi kontabilitetin Financiar*
- *Ligji mbi privatizimin;*
- *Ligji mbi investimet e huaja (është përgatitur por nuk është akoma në fuqi)*

Mirëpo, krijimi i infrastrukturës financiare ballafaqohet me probleme serioze, ndonëse pas aprovimit të rregullave përkatëse mund të vërehen tendenca përmirësimi. Zyrtarizimi i përdorimit të markes gjermane si mjet pagese ka krijuar një stabilitet dhe siguri në transaksionet ekonomike dhe financiare por edhe të financave publike, efekteve të politikës fiskale duke i neutralizuar efektet negative nga jostabiliteti i mundshëm i valutave në vendet fqinje

Nuk është e zgjidhur akoma problemi i infrastrukturës së pagesave të brendshme dhe të jashtme. Faktikisht ekziston vetëm një bankë e mbrojtur nga konkurenca. Mungon politika dhe instrumentet për stimulimin e zhvillimit ekonomik, ndërsa transformimi i pronës shoqërore akoma qëndron në pikën fillestare të zgjidhjes së tij. Hezitimi për transformimin e pronës shoqërore sipas modeleve tashmë të njohura në vendet në tranzicion sikurse edhe në vendet e dalura nga ish Jugosllavia po ndeshet me dilema, moskuptime dhe probleme të panevojshme.

Në kushtet specifike të pasqyruara, në mungesë të parametrave makroekonomik dhe të indikatorëve të tjerë relevant për formulimin dhe implementimin e politikës fiskale në këtë periudhë në bazë të cilëve do të pasonte një orientim i kjoqhtë dhe i bazuar i zhvillimit ekonomik të Kosovës, politika fiskale po siguronë mbulimin e disa shpenzimeve publike, duke pretenduar një rritje përmanente të pjesës së brendshme të të ardhurave. Politika fiskale po përcakton dhe rregullon instrumentet tatimore dhe doganore, duke mos vënë në pah sa duhet qëllimin që normat e tatimeve, doganave e akcizave dhe taksave të tjera të mos kenë vetëm karakter thjesht fiskal por të jenë edhe në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik.

Problemet e Kosovës së posaçliruar kërkuan veprime shumëdimensionale të faktorit ndërkombëtar dhe atij vendor. Këto veprime u orientuan në realizimin e fazës emergjente dhe asaj substancionale të rindërtimit dhe në ngritjen e organeve dhe insituciove të përkohshme të administratës publike në Kosovë. Me qëllim që të lehtësohet shpërndarja e fondeve të donatorëve por edhe të krijohen parakushtet për vjeljen e taksave vendore, nga shtatori i vitit 1999 filloi procesi i ndërtimit të administratës financiare në territorin e Kosovës.

Ngritja e një autoriteti me attribute të Ministrisë së Financave është cilësuar me prioritet të lartë nga ana e UNMIK-ut. Autoriteti Qendror Fiskal po punon për të krijuar një sistem të menaxhimit buxhetor, të aftë për të alimentuar burimet financiare në kohë dhe për të siguruar që këto burime të shpenzohen me transparencë dhe eficiencë. Autoriteti Qendror Fiskal i krijuar në Kosovë ushtron funksionet themelore të Ministrisë së Financave si janë formulimi i strategjisë së përgjithshme fiskale duke marrë parasysh kushtet makroekonomike dhe ndikimin e politikës fiskale në zhvillimin ekonomik. Ai poashtu bashkërendit programet e shpenzimeve publike (përmes planifikimit të buxhetit dhe thesarit) si dhe kontrollon shpenzimet aktuale; formulon politikat e taksave dhe doganave dhe administron dhe kontrollon mbledhjen e tyre.

Autoriteti Qendror Fiskal me krijimin e administratës tatimore ka arritur që ti kyçi kuadrat locale më shumë se që arritën të bëjnë këtë departamentet e tjera. Kjo është me rëndësi për kyqjen e ekspertëve vendas në hartimin e politikave ekonomike në kuadër të administratës së publike.

Në periudhën e deritanishme grumbullimi i taksave dhe doganave dhe shpërndarja e mjeteve buxhetore është bërë në mënyrë të centralizuar në nivel të Autoritetit Qendror Fiskal. Komunat deri tani përfituan grantet nga autoriteti qendror për mbulimin e shpenzimeve të tyre themelore funksionale. Në anën tjetër në Kosovë është mjaft e përhapur dëshira për decentralizim të autoritetit fiskal në 29 komuna sa sot ajo numron. Një çasje e tillë mund të jet edhe si rrjedhojë e përvojave të një sistemi mjaft të decentralizuar fiskal para vitit 1990 si dhe të gjendjes shumë të rëndë të objekteve dhe infrastrukturës komunale në lokalite të ndryshme të Kosovës zgjidhja e të cilave

kërkohej nga autoritetet lokale. Mirëpo vlerësohet se një decentralizim më i fortë fiskal është i limituar me ndryshimet që kanë të bëjnë veçmas me nivelin e zhvillimit të komunave, të ardhurave për kokë të banorit si dhe në dallimet shumë të mëdha territoriale dhe të numrit të banorëve në mes komunave.

***Mendimet e komunitetit të biznesit lidhur me pengesat që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik***

Mungesa e kornizës ligjore, konkurrenca jolojale dhe tatimet e larta aktuale si dhe çështjet e tjera relevante të cilat pengojnë zhvillimin, ndërsa janë në korelacion me politikën fiskale, kanë qenë në fokus të pjesës së anketës me 300 ndërmarrje private që është realizuar nga Riinvest në dhjetor të vitit 2000. Në vazhdim po i veçojmë disa nga konstatimet më specifike:

- Nga 16 pengesat e përfshira në anketë, të cilat ndikojnë në zhvillimin e bizneseve në Kosovë, 88% e të anketuarave vlerësojnë se pengesë kryesore paraqitet “mungesa e ligjeve”.
- Në vendin e dytë, menjëherë pas kësaj, 76% e të anketuarave theksojnë si pengesë e madhe është “konkurrenca jolojale”.
- Në vazhdim, si pengesë e tretë me radhë, ose 63% e të anketuarave vlerësojnë mungesën e burimeve të jashtme financiare.
- “Tatimet e larta” konsiderohen në bazë të anketës si pengesa e katërt më serioze nga 50% e të anketuarave.

Anketa e Riinvestit, Dhjetor 2000      Pengesat specifike në biznes sipas intensitetit

<u>Pengesat</u>	<u>Intensiteti i faktorëve</u>
- Mungesa e ligjeve	10.4
- Konkurrenca jolojale	9.3
- Mungesa e burimeve të jashtme financiare	8.2
- Tatimet e larta	7.4
- Konkurrenca e ashpër	7.2
- Mungesa e informatave	7.0
- Sigurimi i materialit, makinave dhe pajisjeve	6.2
- Kapacitetet e pamjaftueshme	6.0
- Vonesat e pagesave	5.8
- Ngarkesat administrative	5.2
- Mungesa e kërkesës	5.2
- Rregullimi i pagesave me firmat e tjera	4.9
- Pengesat për eksport	4.7
- Pariteti në mes valutave - inflacioni	4.3
- Niveli i aftësisë të punonjësve	4.1
- Mungesa e aftësive manaxheriale	3.9
Gjithsej	100

Investitorët seriozë, sidomos ata nga bota e jashtme, ende hezitojnë që t'i shtrijnë aktivitetet e tyre në Kosovë edhe për shkak të pasigurisë juridike, e sidomos të asaj fiskale, meqenëse ende jemi larg që të rumbullaksohet rregullativa ligjore fiskale dhe tatimore. Nuk dihet se kur do të fillojë që aplikohet tatimi në fitim të kompanive dhe me çfarë norme, TVSH-ja, tatimet dhe kontributet në paga, etj.

## **VI. STRUKTURA EKZISTUESE E OBLIGIMEVE FISKALE NË KOSOVË**

### **PJESA E PARË- PASQYRË E INSTRUMENTEVE FISKALE**

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara pas vendosjes së saj në Kosovë u ballafaqua me një pasiguri lidhur me vendosjen e një sistemi juridik adekuat dhe të pranueshëm për situatën e re të pasluftës. Në fillim ishin të pranishme disa dilema lidhur me atë se cilat ligje do të mbesin në fuqi. Të njëjtat u kuartësuan dukshëm me nxjerrjen e **Rregullores mbi ligjet në fuqi në Kosovë**, sipas së cilës të zbatueshme janë ligjet e Kosovës që ishin në fuqi deri më 22 Mars 1989. Mirëpo, kjo nuk ishte e mjaftueshme pasi që rregullativa ligjore e Kosovës së asaj kohe edhe pse ishte dukshëm më e avancuar se në vendet tjera ish socialiste megjithatë ishte larg standardeve të ekonomisë së tregut dhe të një ekonomie të hapur për integritime rejonale, evropiane dhe botërore në mënyrë që të të jenë kompatible me sistemet e vendeve të zhvilluara perëndimore. Duhet theksuar se aktiviteti i shtyllës IV të UNMIK-ut ishte mjaft i përqendruar në çështjet kyçe dhe frytdhënëse. Në saje të kësaj janë nxjerrur rregullore të cilat parqesin hapat e parë por të rëndësishem edhe për ndërtimin e sistemit të ri fiskal në Kosovë.

#### **(i) Doganat dhe tatimi në shije**

Ndër rregulloret e para të nxjerrura nga Përfaqësuesi Special i KB për Kosovën është edhe ajo mbi themelimin e doganave dhe shërbimeve tjera gjegjëse në Kosovë. Me këtë Rregullore, me Rregulloren mbi akcizën dhe Rregulloren mbi taksën e shitjes fillon të funksionojë shërbimi doganor dhe pagesa e taksës dhe te akcizës në importimin e mallrave si një ndër segmentet më të rëndësishme të (i) ndërtimit të sistemit fiskal të Kosovës dhe të (ii) institucionalizimit dhe konsolidimit të buxhetit të Kosovës.

### **Problemet**

- *Karakteri linear i instrumenteve fiskale* - Instrumentet ekzistuese fiskale janë të karakterit njëdimensional që do të thotë sigurojnë të hyrat buxhetore duke lënë anash inkorporimin edhe të elementeve të politikës zhvillimore të Kosovës. Tarifat doganore dhe ato tatimore janë lineare dhe si të tilla nuk favorizojnë produktet që janë të dedikuara për procesin e prodhimit ose investimet (lënda e parë, paisjet, etj.)
- *Përfshirja e pamjaftueshme e komponentës zhvillimore* - Me rastin e futjes së instrumenteve të reja fiskale duket se nuk është vlerësuar sa duhet se sa ato si tërësi e ngarkojnë biznesin në Kosovë, sa e stimulojnë apo në çfarë mase e ngulfatin atë.
- *Trajtimi preferencial i IRJM-* Mbetja në fuqi e Marrveshjes mbi njohjen e regjimit preferencial tregtar midis ish RFJ dhe IRJM, sipas së cilës mallrat që e kanë origjinën nga ky vend nuk paguajnë tarifa doganore por paguajnë një tarifë administrative prej një përqind ka krijuar pabarazi të importuesitë dhe ndikim destimulativ të prodhuesit e vendit. Zbatimi i marrëveshjes së tillë nuk krijon efekte reciprociteti dhe nuk është në funksion zhvillimor të Kosovës. Mallrat të cilat importohen nga IJRM janë kryesisht të konsumit të përgjithshëm, kurse nuk kemi të bëjmë me importim të teknologjisë dhe pajimeve, lehtësitë doganore për të cilat do të kenë efekte të ardhshme zhvillimore.. Edhe vonesa për vendosjen e zyrave të doganave në vendkalimet kufitare me Serbinë dhe Malin e Zi ka krijuar hapsirë për shmangje të obligimeve doganore dhe tatimore nga importuesitë e pandërgjegjshëm. Kjo krijon pabarazi në treg ndaj importuesve të cilët i respektojnë obligimet tatimore dhe doganore.

Pas nxjerrjes së rregullore mbi regjistrimin e përkohshëm të bizneseve (29 shkurt 2000) u krijuan kushtet për legalizimin e bizneseve në Kosovë dhe identifikimin e tatimpaguesve potencialë. Me këtë janë krijuar kushtet për implementimin e tatimeve në fuqi, me gjithë faktin se ende nuk ekziston një strukturë complete dhe e qëndrueshme tatimore.

**Tabela 1. Struktura e instrumenteve fiskale dhe përqindja e ngarkesës**


<i>Nr. ren</i>	<i>Lloji i instrumentit fiskal</i>	<i>Përqindja e ngarkesës</i>
1	<i>Dogana</i>	10
2	<i>Taksa në shitje</i>	15
3	<i>Tatimi në shërbimet hoteliere</i>	10

4	Tatimi i paragjykuar (deri në 15.000 DM brutoqarkullim)	75-400DM
5	Tatimi i paragjykuar (mbi 15.000 DM)	3
6	Taksa në regjistrimin e automjeteve	Nga 45, e diferencuar sipas vëllimit të automjetit

### ***Krahasimi me vendet e tjera***

Sipas vlerësimeve pjesëmarrja e doganave, tatimeve dhe taksave në GDP në Kosovë sillet rreth 7%, kurse në vendet e rajonit sillet prej rreth 15% në Shqipëri deri në 46% në ish Jugosllavi. Ndërsa ngarkesa e përgjithshme fiskale është shumë e pavolitshme në Kosovë në dëm të komunitetit të biznesit. Kjo më së miri shifet nga pasqyra vijuese.


**Struktura e të hyrave nga doganat, taksat dhe tatimet në Kosovë**



Kjo strukturë ndryshon dukëshëm nga ajo e vendeve në tranzicion (shih aneksin ) dhe të OECD, gjë që më së miri shihet në grafikun vijues. Struktura e të ardhurave fiskale në Kosovë, sikurse edhe shpenzimet publike, është shumë e thjeshtëzuar. Rreth 41% të të hyrave fiskale e përbëjnë doganat dhe akcizat, kundrejt asaj që në vendet e OECD-së në vitin 2000 doganat dhe akcizat përbënin 11% të të hyrave fiskale. Tatimi në shitje (që paguhet në kufi gjatë importimit të mallit) me normë prej 15% përbën pjesën tjetër prej 53% të të ardhurave fiskale. E gjithë kjo flet për një koncentrim tepër të madh të ngarkesave fiskale mbi komunitetin e biznesit dhe mbi nevojën e shtrirjes së këtyre ngarkesave mbi obliguesit e tjerë, karshi përvojave në vendet fqinje, të atyre në tranzicion dhe të vendeve të zhvilluara.



### Struktura e te hyrave nga taksat ne vendet e OECD-se



Nga paraqitja e mësipërme grafike shifet një shpërndarje më e gjërë e ngarkesave fiskale në vendet e OECD-së. Nga kjo mund të shihet se pjesëmarrja e bizneseve në vendet e OECD-së në të hyrat e përgjithshme fiskale sillet prej 45-60%, ndërsa në Kosovë kjo përqindje është mbi 95%.

#### (ii) Tatimi në shërbimet hoteliere

Autoritetet e UNMIK-ut kanë bërë përpjekje serioze për themelimin e administratës tatimore dhe janë arritur rezultate të konsiderueshme në këtë drejtim sikurse edhe në aftësimin e stafit profesional. Mirëpo, vërehen mangësi të theksuara në dispozitat e Rregullores mbi tatimin në shërbime hoteliere dhe Rregullores mbi tatimin e paragjykuar. Mendojmë se me mënyren e zbatimit të këtyre tatimeve për disa kategori të tatimpaguesve krijohen disavantazhe e disa të tjera janë të privileguara. Me dispozitat në fuqi të cilat rregullojnë caktimin dhe inkasimin e tatimit në shërbimet hoteliere parashihet se subjektet që nuk arrijnë brutoqarkullimin mujor deri në 15.000 DM lirohen nga tatimimi sipas normës prej 10% në brutoqarkullim, ndërsa tatimohen vetëm me shumë paushalle prej 400 DM. për një tremujor. Kjo metod e tatimimit, sipas Rregullores në fuqi, nuk është stimuluese por as nuk premtion efekte më të sigurta fiskale.

#### (iii) Tatimi i paragjykuar

Gjithashtu edhe tatimi i paragjykuar nga tatimpaguesit po vlerësohet si pengesë serioze për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Norma tatimore prej 3% në brutoqarkullim është shumë e lartë, e kur dihet se në bazën e tatueshme hynë edhe dogana prej 10% mbi të cilën vlerë llogaritet tatimi në shitje prej 15%, që inkasohen në kufi, që do të thotë tatim mbi tatim. Kjo në njëfarë mënyre e stimulon evazionin fiskal, sidomos nën rrethanat e mungesës së dokumentacionit afarist dhe të evidencës financiare tek subjektët afaristë. Tatimi i paragjykuar sidomos është i disfavorshëm për tregtarët me shumicë, shpesh ndodhë të jetë më e madhe se 50% nga marzha e fitimit.

*Tatimi i paragjykuar dhe vendndodhja e tatimpaguesve*

Vendndodhja e aktivitetit ekonomik, e kategorizuar në tri grupe( A-Prishtina, B-Ferizaji, Prizreni, Gjakova, Peja dhe Gjilani dhe C-të gjitha zonat që nuk përfshihen në vendndodhjen A dhe B) sipas përkatësisë regjionale nuk duket të jetë e qëlluar si përkrah shtrirja ashtu edhe si synim i paragjykimit të kapacitetit fiskal në regjionet e caktuara. Kjo metodë e kategorizimit të tatimpaguesve mund të shkaktojë çrregullime në qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, politikën e çmimeve, bartjen e tyre fiktive, por edhe faktike, nga një regjion në tjetërin.

Mendohet se nuk është zgjidhur metoda më adekuate që të materializohet qëllimi i ligjdhënësit që të favorizohen kategoritë më të dobëta të tatimpaguesve. Kjo, mbase, ka mundur që të jetë më e efektëshme me kategorizimin e tatimpaguesve sipas zonave të caktuara brenda një regjioni, fshatrat dhe qyteti, gjegjësisht brenda qytetit – qendra dhe periferia.

**(iv) Akciza**

Taksa e akcizës është duke u aplikuar që nga janari i këtij viti. Shkallët e ngarkesës me taksën e akcizës janë të diferencuara, prej 10 – 50%, duke i favorizuar produktet e konsumit familjar, pijet freskuese, etj.

Produktet që iu nënshtrohen taksës së akcizës:

- Kafja në vlerën prej 30%
- Pijet freskuese në vlerën prej 10%
- Birra prej maltit 0,3 DM për litër
- Vena prej rrushit të freskët, vermuti dhe venat tjera të rrushit të pasuruara me bimët aromatike 0,4 DM për litër
- Pijet e tjera të fermentuara 0,3 DM për litër,
- Etilalkoholi dhe pijet e tjera me fortësi mbi 80% (shpirtusi, likeri dhe pijet e tjera të shpirtuesit), 2 DM për litër.
- Cigaret, 4 DM për 1000 cigare,
- Cigaret, cigarillos dhe duhani, 50% në vlerë.
- Benzin, 30 fening për litër,
- Gas dhe vaj 25 fening për litër,
- Diesel, D1 dhe D2, 25 fening për litër,
- Kerozin, 25 fening për litër,
- Naftë për ngrohje, 25 fening për litër,

- Telefonat mobil, 15% nga vlera,
- VCR, 15% nga vlera
- Aparatet TV 15% nga vlera
- Antenat satelitore, 15% nga vlera
- Mjetet motorike dhe mjetet e tjera për udhëtarë, 20% në vlerë plus 1000 DM për secilin.

#### Mallrat e liruar nga obligimet fiskale

*Në produktet e liruar nga obligimet tatimore, doganore dhe akciza përshihen:*

- I tërë eksporti;

Importimi i këtyre mallrave:

- Qumështi;
- Vajrat dhe yndyrat ushqimore;
- Pemët, perimet;
- Mielli i grurit;
- Prodhimet farmaceutike;
- Aparatet dhe instrumentet për mjekësi dhe kirurgji;
- Pullat postale dhe letrat me vlerë;
- Plehërat artificiale;
- Mallrat e importuara nga UNMIK, KFOR, UNHCR, ICRC, Kryqi i Kuq dhe Gjysemhana e Kuqe, OJQ me status të beneficuar publik;
- Mallrat e importuar nga përfaqësitë diplomatike, misionet konzulore për nevojat e tyre zyrtare;
- Mallrat blerja e të cilave financohet nga UNMIK-u , qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, të mbështetura nga programet dhe projektet humanitare dhe të rindërtimit në Kosovë.

#### ***Opinioni i komunitetit të biznesit në Kosovë lidhur me strukturën ekzistuese fiskale***

Shumica e konkluzioneve nga anketimi që e ka zhvilluar Riinvest me 192 ndërmarrje shoqërore dhe me 300 ndërmarrje private flet për ate se struktura ekzistuese e tatimeve nuk korespondon në masë të mjaftueshme me objektivat zhvillimore. Nga perspektiva e biznesit konsiderohet e nevojshme të rishqyrtohet struktura ekzistuese e ngarkesave fiskale dhe sipas mundësive të modifikohet dhe të reduktohet.

Manaxherët e ndërmarrjeve shoqërore posaçërisht bëjnë vërejtje në sistemin aktual fiskal.

- Shumica e ndërmarrësve shoqërore (73,2%) janë deklaruar se doganat dhe tatimet janë pengesë për ristartimin e biznesit të tyre, ndërsa vetëm 9.8% prej tyre theksojnë se ato janë stimulative
- Në përgjithësi kërkojnë që importimi i lëndës së parë të lirohet nga doganimi si faktor nxitës për ristartimin dhe ringjalljen e ndërmarrjeve, s'paku për dy vite,

- Të lirohen nga dogana ndërmarrjet të cilat importojnë teknologjinë e nevojshme dhe paisjet për teknologjinë e shkatrruar, vjedhur në luftë dhe për veprimtarinë e agrobiznesit.
- Të eliminohet paradoksi lënda parë (gruri) për produkte ushqimore tatimohet dhe doganohet, ndërsa produktet e gatshme ( mielli ta zëmë) jo
- Heqja e doganës për pjesë këmbimi dhe repromaterial .
- Kërkojnë që të bëhet vlerësimi i politikës doganore dhe tatimore, në mënyrë që të mbështet orientimi i ndërmarrjeve prodhuese dhe i atyre që eksportojnë.
- Një pjesë e ndërmarrësve propozon aplikimin e doganave selektive për disa veprimtari, në mënyrë që të stimulohet prodhimi në krahasim me veprimtaritë e tjera (tregtinë).
- Duhet të aplikohet akciza për produktet e jashtme për shkak të nxitjes së ekonomisë vendase, përkatësisht stimulimi i produkteve të tyre.
- Dhe në fund si vërejtje lidhur me doganën e tanishme të një pjese të ndërmarrësve mendojnë se preferencat ndaj IRJM të janë se doganat janë stimuluese për Maqedoninë e jo edhe për Kosovën.
- Është paradoksale fakti që autoritetet e disa nga shtetet fqinje aplikojnë taksa shtesë për kalimin e mallit tranzit vetëm ndaj afaristëve kosovarë.

Vërjetjet e ndërmarrësve privat sipas anketës së Riinvest me 300 ndërmarrje private:

- Doganat i vlerësuan të larta ose të papërballueshme 62% e të anketuarve, ndërsa 37% të përballueshme.
- Akcizat i vlerësuan të larta dhe të papërballueshme 56% dhe të përballueshme 29%.
- Tatimi në shtitje në kufi i vlerësojnë të lartë dhe të papërballueshëm 49%, ndërsa të përballueshme 45%,;
- Taksat në shërbime i vlerësuan të përballueshme 50%, kurse të lartë dhe të papërballueshëm 37%.
- Tatimin e paragjykuar e vlerësojnë të përballueshëm 52%, ndërsa të lartë dhe të papërballueshëm 41%.

## PJESA E DYTË – REZULTATET FISKALE TË ARRITURA GJATË VITIT 2000 NË KOSOVË

Të ardhurat e parapara sipas buxhetit të Konsoliduar për vitin 2000 (pjesa e brendshme nga doganat dhe taksat) dhe të ardhurat e realizuara në periudhën 7 Janar-18 Nëntor 2000

Nr	Të ardhurat	Vlerësuar		Realizuar	
		Shuma	%	Shuma	%
1	Doganat	38.000.000	19.10	53.264.125	26.27
2	Akcizat	21.000.000	10.55	30.140.499	14.86
3	Tatimi në shitje	104.000.000	52.26	107.711.163	53.14
4	Tatimi në hot. dhe ushqime	11.000.000	5.53	2.891.370	1.43
5	Tatimi në profit	5.000.000	2.51		
6	Tatimi në paga	15.000.000	7.54		
7	Tatimi në ekonominë e vogël	5.000.000	2.51		
8	Tatimi i paragjykuar	-		8.710.074	4.3
	<b>Gjithsej tatimet</b>	<b>199.000.000</b>	<b>100</b>	<b>202.717.231</b>	<b>100</b>

Gjatë vitit 2000 janë paraparë të ardhurat buxhetore në shumë prej 423.232.885 DM. Në të ardhurat buxhetore janë paraparë edhe të ardhurat nga tatimi në profit dhe ato nga tatimi në paga, të cilat tatime nuk janë aplikuar akoma.

Sipas të dhënave për inkasimet deri më 18 nëntor 2000 shifet se ato i tejkalojnë parashikimet për tërë vitin. Ngecë vetëm tatimi në shërbime. Kjo shifet nga tabela e të ardhurave të parapara për buxhetin e konsoliduar për vitin 2000 (pjesa e brendshme). Sipas shënimeve të përpunuara nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe nga Banka Botërore, shumë nga detyrimet fiskale, veçanarisht doganat dhe akcizat, kanë ngecur në pjesën e parë të këtij viti, dhe të ardhurat do të ishin shumë më të larta po mos të ndikonin këto rrethana:

### PJESA E TRETË – EVAZIONI FISKAL

Evazionin fiskal gjatë kësaj periudhe kryesisht është ndikuar nga këta faktorë:

- Mbulimi i jo i plotë i pikave kufitare, hyrëse, në Kosovë ka ndikuar në mospagimin e obligimeve fiskale. Artikujt me vlerë të lartë akcize kanë hyrë në sasi të mëdha nga Mali i Zi, në të cilën pikë UNMIK-u ka vënë kontrollën në mars të këtij viti. Vlerësohet se vonesa dymujore e vënjes së pikës kufitare me Malin e Zi nga muaji janar në muajin mars e ka dëmtuar buxhetin e Kosovës për 20 milion DM. Poashtu nuk janë mbuluar dhe nuk aplikohen taksat dhe tarifat doganore në pikat hyrëse me Serbinë ndaj së cilës akoma nuk është aktivizuar statusi doganor.
- Njohja nga ana e UNMIK-ut e regjimit preferencial tregtar midis RFJ dhe IJRM, për territorin e Kosovës, ka lënë mundësi jo vetëm që të importohen mallrat nga IJRM me tarifë simbolike, por të futen në Kosovë edhe mallra me qertifikata të falsifikuara të origjinës të prezentuara se janë me origjinë maqedonase.
- Lënja jasht rolit dhe përgjegjësisë fiskale e pushtetit lokal gjatë kësaj periudhe

- Niveli i lartë i doganave dhe i taksave për mallrat e importuara dhe koncentrimi i detyrimeve tatimore vetëm në biznes bëri ndikim që tatimpaguesit të aplikojnë forma të ndryshme të evazionit fiskal, duke i ikur pagesës së detyrimeve apo duke i paguar vetëm pjesërisht.
- Mungesa e dokumentacionit afarist dhe e evidencës financiare tek subjektët afaristë që është edhe reflektim i mungesës së rregullativës përkatëse ligjore.
- Me mos përfshirjen e të gjithë obliguesve në pagimin e detyrimeve tatimore dhe doganore për shkak të lëshimeve administrative gjatë zbatimit të procedurave doganore dhe tatimore krijohen pabarazi të subjekteve në treg dhe rrisin tendencën për shmangje ndaj këtyre obligimeve edhe nga ata të cilët janë të gatshëm t'i përmbushin.

### ***Opinioni i komunitetit të biznesit për evazionin fiskal***

- Gatishmëria e afaristëve kosovarë për pagimin e detyrimeve fiskale, sipas anketimit të 300 ndërmarrjeve private konsiderohet të jetë mesatare (64% e tyre), 20% e konsiderojnë të ulët dhe vetëm 15% të lartë.

Ndërsa lidhur me atë se sa instrumentet fiskale janë të pranueshme në komunitetin e biznesit tregojnë të dhënat e mëposhtme:

- Lidhur me pengesat kryesore për pagimin e tatimit dominon me 29% shkaku se të tjerët nuk e paguajnë
- Nga ta, 27% mendojnë se është shkak mungesa e kontrollës së duhur;
- 24% e theksojnë si shkak mungesën e shprehisë për pagimin e tatimit, kurse
- 21% e vlerësojnë lartësinë e tatimeve si pengesë kryesore

Nga kjo mund të vlerësohet se friga nga kushtet e pabarabarta të afarizmit në treg, të cilat krijohen nga pabarazia në ekzekutimin e detyrimeve fiskale i shtyn firmat private t'u ikun detyrimeve fiskale

## **VII NORMA TË DIFERENCUAR APO LINEARE FISKALE**

Në konceptimin e deritanishëm të politikës fiskale nuk janë përcaktuar instrumente stimulative dhe lehtësuese për zhvillimin ekonomik, sidomos të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private. Në praktikën e deritanishme tek ne nuk janë zbatuar lehtësi doganore dhe tatimore për investitorët rezident por edhe për ata të jashtëmit. Këto masa sigurisht se do të stimulonin dhe do ta mobilizonin angazhimin e kapitalit në sferat prodhuese përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private dhe shoqërive të përbashkëta me kapital përzier me investitorë të jashtëm.

## **Shembujte ndërkombëtarë që përmes instrumenteve fiskale stimulhet zhvillimi i biznesit**

Në praktikën e vendeve të OECD dhe të vendeve në tranzicion aplikohen një mori e masave të stimulimit tatimor siç janë:

- Lirimi i plotë nga tatimi (norma zero),
- Lehtësitë tatimore,
- Subvencionet dhe premitë.

Krahas kësaj, nga vendet e zhvilluara industriale janë të njohura përvojat mbi stimulimet e investimeve të reja dhe atyre të përbashkëta përmes masave të ndryshme siç janë:

- Normat më të ulta të tatimit;
- Lehtëstë në tatim;
- Zvoglimi i shkallës doganore;
- Caktimi i kohës së pushimit të obligimit tatimor;
- Mundësia e amortizimit të përshpejtësuar etj.

Lehtësime tatimore për të stimulur zhvillimin dhe investimet e jashtme janë të njohura edhe nga përvojat e shteteve, të cilat kanë kaluar, apo gjenden në faza të ndryshme të tranzicionit kah ekonomia e tregut si janë Argjentina, Brazili, Çilea, Turqia, Qipro, Malta, Egjipti, Afrika Jugore, India, Izraeli, Korea Jugore, Kina, e që përmbledhet në këto masa:

- nuk zbatohen dogana në importin e lëndëve të para që iu shërbejnë investitorëve të jashtëm për prodhim;
- nuk paguhen dogana për importet e pajisjeve për investitorët e jashtëm;
- ofrohen lirime tatimore nga tatimi në fitim për përfitimin e reinvestuar dhe fitimin e realizuar në vitin e parë të punës;

Lirime tatimore lejohen edhe në:

- Në investimet në bujqësi dhe në ekonominë turistike,
- Në rajonet e pazhvilluara,
- Qytete të vjetra dhe në
- Zona speciale ekonomike.

Në situatën konkrete tek ne, në Kosovën e pas luftës, lehtësime doganore do të zbatoheshin vetëm në raste kur ato do të nxitnin zhvillimin ekonomik. Përgjashtime nga obligime doganore do të zbatoheshin për importet e teknologjive dhe materialeve, të cilat formalisht nuk mund ta deformatojnë konkurrencën e tregut, meqenëse nuk prodhohen apo nuk gjenden në tregun e brendshëm.

## **Mendimet e komunitetit të biznesit lidhur me normat e diferencuara të obligimeve fiskale**

**Këtu është marrë në konsiderim mbështetja e komunitetit të biznesit për norma të diferencuara.** Sipas rezultateve të Anketës së Riinvestit të zhvilluar në 300 ndërmarrje private në Dhjetor të vitit 2000, del se:

- 98% të të anketuarve shprehen për nevojën e lehtësimeve doganore për veprimtari të caktuara.
- Për dogana të diferencuara shprehen 85%, kurse vetëm 15% të të anketuarëve konsiderojnë se ato duhet të jenë lineare,
- Për tatime të diferencuara shprehen 72%- tatimi në shitje, 64% - tatimi në shërbime dhe 65% tek tatimi i paragjykar.
- Pjesa dërmuese prej 92% konsidero detyrimet fiskale të diferencuara duhet të zbatohen ndaj lëndës së parë; 90% për pajime për prodhim, 82% për paisje për bujqësi dhe 83% për repromaterial për prodhimet e destinuar për eksport.

Duke patur parasyshë nevojën për stimulimin e investimeve dhe ringjalljen ekonomike të pasluftës, **lirimet e pjesëshme nga doganat dhe tatimet për teknologji dhe prodhime të caktuara duhet kuptuar si investim** për krijimin e efekteve të ardhshme buxhetore dhe stimulimn e punësimit më dinamik. Nuk është e arsyeshme që zgjidhja për mbushjen e buxhetit të gjendet përherë në rritjen e taksave dhe tatimeve. Cdo lehtësim (apo politikë diferencuese tatimore) do të justifikohet vetëm nëse do ta ketë bazën e shëndoshë ligjore dhe nuk do të varej nga vendimet arbitrare dhe pa mbështetje ligjore të cilat do ta stimulonin evazionin dhe çrregullimin e konkurrencës në treg.

## **VIII. TATIMET E REJA ME THEKS TË VEÇANTË NË TATIMIN NË VLERËN E SHTUAR (TVSH)**

Përvojat e pasluftës në zbatimin e tatimeve dhe doganave në Kosovë hapin shtigje për përparimin e politikës fiskale përmes zgjerimit të llojeve të tatimeve dhe bazës tatimore; aplikimit të tatimeve të reja ose zëvendësit të disa tatimeve ekzistuese me tatime të reja. Hulumtimet e deritanishme veçmas të opinionit të biznesit flasin për nevojën e **zëvendësimit të tatimit në qarkullim (në shtitje) me tatimin në vlerën e shtuar dhe për zëvendësimin e tatimit të paragjykuar me tatimin në të ardhura të firmave.** Në anën tjetër nuk ka arsyetim për zhagritjen e mëtejme të zbatimit të tatimit në paga si të personelit lokal ashtu edhe të atij ndërkombëtar i cili punon dhe realizon paga në Kosovë. Një hap i tillë jo vetëm që do ta përmirësonte buxhetin por edhe do të krijonte opinion të volitshëm për një qasje konstruktive ndaj obligimeve të përgjithshme fiskale të firmave edhe të qytetarëve.

## **Mendimet e komunitetit të biznesit lidhur me futjen e tatimeve të reja**



Janë mjaft interesante mendimet e ndërmarrjeve private sa i përket aplikimit të tatimeve të reja për vitin 2001, të cilat po i prezentojmë në vijim:

- Aplikimin e tatimit në vlerën e shtuar e vlerësojnë plotësisht të pranueshëm 38%, e konsiderojnë pjesërisht të pranueshëm 32% dhe vlerësojnë se nuk ka kushte për aplikimin e tij 23%. Ky aplikim natyrisht se vlerësohet se do të bëhet duke zëvendësuar tatimin në qarkullim (tatimit në kufi prej 15% i cili zbatohet tani). **Kjo do të thotë se futjen e TVSH – së e përkrahin 70% të të anketuarëve, qoftë si plotësisht apo pjesërisht të pranueshëm.**
- Tatimin në fitim e vlerësojnë plotësisht të pranueshëm 48%, 33% pjesërisht të pranueshëm dhe nuk ekzistojnë kushtet 13%. **Me fjalë të tjera, 81% e të anketuarëve e përkrahin futjen e tatimit në fitim, softë si plotësisht apo si pjesërisht të pranueshëm.**
- Tatimin në paga e vlerësojnë plotësisht të pranueshëm 38%, pjesërisht të pranueshëm 30% dhe se nuk ekzistojnë kushtet për aplikimin e tij vlerësojnë 26%. **Me fjalë të tjera, këtë tatim e përkrahin 68% e të anketuarëve, qoftë si plotësisht apo si pjesërisht të pranueshëm.**

#### TVSH

Kalimi nga tatimit në shitje (përkatësisht atij në qarkullim që paguhet në kufi) në tatimin në vlerën e shtuar kërkon kujdes dhe përgatitje të veçantë. Tatimi në vlerën e shtuar është zbatuar në të gjitha shtetet e Bashkësisë Europiane, në disa shtete të Azisë dhe të Amerikës Latine. Mirëpo si i tillë ai më së tepërmi lidhet me UE, ku jo vetëm që është i obliguar por kryesisht është i harmonizuar në mes të shteteve në bazë të udhëzimit (direktivës) së gjashtë të këtij Unioni. Mbi gjysma e vendeve të cilat e zbatojnë TVSH-në aplikojnë vetëm një shkallë të tatimit, ndërsa vendet në tranzicion, përpos Bullgarisë, aplikojnë dy shkallë të TVSH-së. UE preferonë shkallën e përgjithshme prej 15-20% dhe shkallën e zvogluar prej 4-9%. Shkallën më të lartë (prej 25%) e kanë Danimarka dhe Suedia, kurse shkallët më të ulta aplikohen në Kanadë 7%, Zvicër 6,5% dhe Japonia 5%. Me rastin e aplikimit të TVSH-s në vendet e OECD-së norma e përgjithshme mesatare sillet në 12,5%, kurse më vonë ajo u ngrit në 17%. Rrethanat në mes të shteteve janë relativisht të ndryshme, gjë që ndikohen nga shumë faktorë, së këndejmi është e pamundur të bëhen krahasime të qëndrueshme të lartësisë së normave në mes tyre.

Aplikimi i TVSH në Kosovë do të inicojë ndryshime thelbësore në sistemin tatimor, prandaj shtrohet pyetja se si do të reflektohen këto ndryshime:

- në buxhet,
- në stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe në
- nivelin e çmimeve.

Të ardhurat nga ky tatim do të varen nga:

- lartësia dhe llojet e normës,
- gjërësia e bazës tatimore dhe nga

- përjashtimet eventuale.

Përvojat nga shtetet e tjera flasin se në periudhën fillestare, aplikimi i këtij tatimi është përcjellur me ngritje të menjëhershme të çmimeve, si refleksion i paguesve tatimor që efektet tatimore t'i bartin tek konsumatori.

Në lartësinë dhe karakterin linear të tatimin në qarkullim (përkatësisht në shitje) i cili tani paguhet në kufi me rastin e doganimit të mallit, ka patur shumë vërejtje të komunitetit të biznesit.

**Edhe përkundër kësaj vlerësohet se koha e fillimit të zbatimit të TVSH dhe efektet e tij do të varen veçmas nga këto parakushte:**

- nga sigurimi i infrastrukturës së domosdoshme institucionale, rregullimit ligjor të evidencës kontable dhe trajnimit për mbajtjen e evidencës,
- nga funksionimi i sistemit bankar dhe kalimi nga transaksionet me para në dorë në transaksione përmes llogarive bankare;
- nga përgatitja në nivel shumë të lartë të obliguesve tatimor, komunitetit të biznesit dhe të administratës tatimore;
- Nevojitet definimi i çdo detaji të rëndësishëm para fillimit të aplikimit të këtij tatimi, duke patur para sysh që aplikimi i tij do të jetë i pa suksesshëm nëse bëhet në nguti dhe nën dëshirën e njëanshme për forcimin e buxhetit, duke neglizhuar efektet e tjera.

## **IX. DECENTRALIZIMI I POLITIKËS FISKALE NË KOSOVË**

Me Rregulloren mbi Qeverisjen lokale në Kosovë të aprovuar në gusht të vitit 2000 viti janë paraparë mënyrat e financimit të komunave nga Autoriteti Qendror Fiskal si dhe burimet e të ardhurave që pushteti komunal mund t'i përfiton në territorin e tij. Këto të ardhura janë:

- Taksat lokale të vlerësuara dhe të mbledhura nga komuna,
- Të ardhurat nga pasuritë komunale dhe
- Gjobat e veçanta.

Pas zgjedhjeve lokale në Kosovë si rezultat i krijimit të realiteteve të reja në komuna, pritet të aktualizohet konceptimi i ri i dimensioneve lokale të politikës fiskale. Sido që të jetë decentralizimi i politikës fiskale do të jetë i varur nga kompetencat dhe përgjegjësitë në organizimin dhe menaxhimin e shërbimeve publike, nga aftësia e administratës komunale (pushtetit lokal) për hartimin e bilanceve të pasurisë së komunave, përkatësisht njësive lokale, nga gjendja dhe pasqyra e tyre territoriale, nga gjendja ekonomike dhe demografike si dhe nga mundësitë e tyre reale për planifikimin dhe realizimin e të ardhurave lokale.

Përvojat e decentralizimit të politikës fiskale nga vendet në tranzicion sikurse edhe nga ato të zhvilluara janë të llojllojshme. Decentralizimi i politikës fiskale është i lidhur me referencat e stabilizimit, shpërndarjen më të mirë të ardhurave dhe privatizimin. Financat lokale kanë lidhje të rëndësishme me politikat e stabilizimit

makroekonomik në ekonomitë në tranzicion dhe krijojnë kushte për zgjerimin e bazës tatimore

Disa shtete në tranzicion kanë transferuar pjesë të rëndësishme të rrjetit të sigurimeve shoqërore, sikurse janë ndihmat familjare, kurse në disa vende edhe pensionet dhe papunësia janë transferuar në një masë të caktuar nga qeveritë qendrore në ato lokale si në Shqipëri, Bullgari, Hungari, Rusi dhe Ukrainë. Mirëpo vlerësohet se qeveritë lokale nuk mundën me sukses t'i kryejnë këto detyra pa u siguruar të ardhurat përkatëse përmes transfereve qeveritare.

Shumë vende kanë transferuar pronësinë e disa ndërmarrjeve shtetërore në nivel lokal. Kështu Qeveritë lokale kanë marrë një rol më të madh për zhvillimin e procesit të privatizimit. Zotërimi i ndërmarrjeve që sigurojnë të ardhura për pushtetin lokal, vlerësohet se është tërheqëse për pushtetet lokale dhe kjo mund të prolongojë ose të minojë procesin e privatizimit të tyre në njërin anë, kurse në anën tjetër mund të çojë në protekcionizëm të brenshëm dhe në krijimin e barrierave tregtare për të mbrojtur monopolet lokale. Këto dukuri janë shprehur më së tepërmi në Rusi.

Të ardhurat e pushtetit lokal në disa shtete të Europës Qendrore (përqindja)

Shteti	Të ardhurat e pavarura dhe të ndara		Grandet shtetërore	
	1997	1998	1997	1998
Estonia	60.7	54.2	24.5	22.5
Latvia	54.4	54.1	32.4	32.7
Lituania	66.5	73.6	16.3	-
Polonia	59.5	58.2	38.3	39.7
R.Çeke	52.0	51.5	22.6	22.1
Sllovakia	36.7	39.5	-	-
Hungaria	35.5	37.2	29.2	31.7
Sllovenia	42.6	41.2	21.7	21.5

Në pjesën më të madhe të vendeve në tranzicion janë aplikuar taksa të llojllojshme për pushtetin lokal. Vendi më të rëndësishëm zen taksa mbi pronën. Mirëpo vlerësohet se rezultatet e arritura në vjeljen e kësaj takse janë mjaft të ulëta për dy shkaqe themelore. Njëra i takon problemit të pronësisë së banesave, përkatësisht të privatizimit të tyre, kurse tjetra ka të bëjë me atë se vendet në tranzicion akoma shërbehen me një bazë të mangët katastrale e cila nuk identifikon në masë të mjaftuar pronën. Problemet e bazës katastrale janë shumë të shprehura në Kosovë nga shkak i grabitjes së dokumentacionit katastral nga pushteti serb para dhe gjatë luftës.

Interesat e pushtetit lokal kryesisht lidhen me organizimin e jetës në komunë, ndërtimet komunale, infrastruktura rrugore, mirëmbajtja dhe higjiena e qytetit, furnizimi me ujë dhe energji, gjelbrimi dhe parqet, tregu publik, transporti urban dhe me kompanitë që i kryejnë këto punë. Për ushtrimin e këtyre veprimtarive, komunat do të shfrytëzonin grantet nga qendra, tatimet dhe taksat komunale dhe të hyrat e tjera.

Burimet e financimit vetanak në Kosovë do të jenë të lidhura me kompetencat që iu lehen komunave nga pushteti qendror, përkatësisht fushëveprimtarinë e komunave sipas lëmenjve të ndryshëm. Nga përvojat e shteteve në tranzicion ekzistojnë avantazhet e caktuara për decentralizimin e politikës fiskale, në të cilin kapaciteti financiar dhe marrja e vendimeve nuk do të lidhej vetëm me qendrën por edhe me pushtetin lokal. Llogaritet se ndër avantazhet më të mëdha është lidhja e këtyre vendimeve me preferencat e politikave dhe ngritja e përgjegjësisë.

Prandaj për të siguruar synimet makroekonomike të zhvillimit të Kosovës dhe të ngarkesës së barabartë të tatimpaguesve nëpër komuna-lokalitete të ndryshme si element i rëndësishëm i krijimit të kushteve të barabarta të afarizmit, vendosja nga ana e pushtetit lokal mbi lartësinë dhe gjërësinë e tatimeve dhe taksave komunale do të ishte e preferueshme të bëhej në suaza të kornizave të cilat paraprakisht do t'i vendosë pushteti qendror. **Kështu që kompetencat duhet të limitohen, duke metur në pushtetin lokal që të organizojë grumbullimin e tatimit në psuri të patundshme, në qarkullimin e pasurisë dhe fitimin nga kapitali, tatimin në qira, tatimin në të ardhura katastrale, taksat në reklama, taksat në ndërtime të reja, në gjueti, dhe ato administrative.** Ky nivel i delegimit të kompetencave në lëminë e politikës fiskale do të krijonte një kornizë solide për rishpërndarje të ngarkesës tatimore midis sektorit të biznesit dhe popullatës në përgjithësi.

## X.PËRFUNDIME

- Mungon strategjia dhe programi i një politike konzistente dhe stabile të taksave, përkatësisht fiskale në përgjithësi:
- Në bazë të rezultateve të inkasimit të obligimeve fiskale në vitin 2000 dhe sipas vlerësimeve të AQF, obliguesit tatimor i kanë pranuar instrumentet aktuale fiskale në mënyrë të kënaqëshme. Mirëpo, sipas rezultateve të Ankëtës së Riinvestit në 300 ndërmarrje private, mund të konstatojmë se komuniteti i biznesit normat tatimore dhe doganore i vlerëson të larta dhe të papërbalueshme. Ndërsa kur është fjala te instrumentet e reja fiskale që parashihen të aplikohen së shpejti komuniteti i biznesit ka kryesist mendim pozitiv.
- Për momentin ne jemi në fazën e ngritjes së administratës tatimore dhe të trajnimit të stafit të tij. Nuk duhet harruar se ky proces kërkon kohë andaj kërkohet gradualitet mes ballafaqimt me tatime komplekse.
- Struktura aktuale e instrumenteve fiskale bazohet vetëm në ngarkesat e biznesit kurse është **e domosdoshme që sa më shpejtë që të jetë e mundur të fillohet me aplikohen instrumente fiskale që do të ngarkonin të ardhurat, pasurinë dhe fitimin e qytetarëve**, mënyrë që arrihet shpërndarja më e drejtë e këtyre detyrimeve në favor të biznesit. Në këtë drejtim duhet të ndiqet përvoja e vendeve në tranzicion dhe vendeve të zhvillara.
- Nisur nga disavantazhet që i trashëgoi ekonomia jonë nga pasojat e luftës, vlerësohet se është në interes të zhvillimit të zvoglohen ngarkesat fiskale ndaj biznesit krahas zgjerimit të bazës **tatimore në mënyrë që pjesëmarrja e e tatimeve ndaj biznesit në strukturën e përgjithshme të ngarkesave fiskale të jetë i ngjashëm me vendet tjera në tranzicion.**
- Politika fiskale të jetë kompatible me parimet e ekonomisë e tregut, si kriter për ndërtimin e një politike të atillë që inkorporon objektivat e zhvillimit makroekonomik ashtu edhe ate mikroekonomik.
- Të ndërtohet një politikë fiskale transparente, e çartë, korrekte, ofiqiente e me preferenca të njëjta për vendet fqinje.
- Politika fiskale në pjesën e taksave dhe tatimeve të zhvillohet si kombinim fleksibil i tipeve të ndryshme të doganave, tatimeve dhe taksave në mënyrë që efektet e **saj të jenë stabilizuese për obliguesit tatimor dhe vet buxhetin, duke stimuluar zhvillimin, investimet dhe krijimin e vendeve të reja të punës.**
- Mospërfshirja e instrumenteve fiskale në nivel lokal si dhe lënja pas dore e administratës tatimore lokale ka ndikuar dukshëm në mospërmblidhjen më të

efektëshme të politikës buxhetore dhe fiskale në periudhën e kaluar. Prandaj, shtrohet si nevojë e ngutshme aplikimi i instrumenteve të reja fiskale në nivel lokal duke aftësuar paralelisht edhe administratën lokale tatimore.

- Në kuadër të sendërtimit të pushtetit lokal do të identifikohen burimet e reja të financimit, si janë tatimimi i pasurisë së patundshme, i qarkullimit të pasurisë së patundshme dhe i fitimit nga kapitali, tatimimi i qirave, tatimi në të hyrat katastrale, taksat në reklama, taksa për ndërtime të reja, për peshkim, gjueti, etj; si dhe taksat për shërbimet e organeve të administratës komunale.
- Përcaktimi i drejtë i ndarjes së të hyrave publike në mes qendrës dhe komunave merr një rëndësi të madhe për krijimin e kushteve të nevojshme për autonominë e pushteteve lokale dhe për ndërtimin e pushtetit qendror. Kriteret duhet të fillojnë nga sistemi i ndarjes së të hyrave burimore në mes pushtetit qendror dhe lokal, sistemi i ndarjes së shpenzimeve në mes pushtetit qendror dhe lokal dhe shkalla e decentralizimit të procesit të vendosjes në përcaktimin e të hyrave dhe shpenzimeve publike në organet e pushtetit qendror dhe lokal.
- Jo disiplina dhe shmangëja nga kryerja e obligimeve fiskale, si pasojë e mungesë së infrastrukturës së nevojshme ligjore dhe mekanizmave më efikas tatimor dhe doganor, po krijojnë efekte negative me pasojë në ndërtimin e politikës së re fiskale në Kosovë.
- Evazioni fiskal duhet të ndërpritet në zanafillën e tij, prandaj me masa të veçanta të politikës fiskale nevojitet të bëhet: **Eliminimi në masë sa më të madhe i ekonomisë joformale dhe futja e saj në rrjedha legale, mbulimi i kufijve të Kosovës me pika të kontrollit doganor dhe tatimor, trajtimi i njejtë i të gjitha shteteve, sigurimi i barazisë së plotë të detyruesve doganor dhe tatimor dhe sigurimi i infrastrukturës juridike për udhëheqjen e evidencës kontable.**
- Në luftë kundër evazionit fiskal, krijimin e vetëdijes së opinionit dhe kulturës fiskale, kontribut të çmueshëm mund të japin edhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare, shoqëatat e afaristëve, mediat dhe institucionet e pavarura hulumtuese dhe shkecore.
- Mund të vlerësohet si posaçërisht e rëndësishme inkuadrimi i nje numri të konsiderueshëm i kosovarëve në AQF. Kjo përvojë duhet të zhvillohet edhe më tej me inkuadrimin e sa më shumë ekspertëve kosovarë në ndërtimin e një politike fiskale konzistente dhe afatgjate.

